



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK TEPELENË

Nr. 1482 prot.

Tepelenë, më 01 . 02 . 2022

VENDIM

Nr. 54, datë 30 . 06 . 2022

PËR

AZHURNIMIN E SEGMENTIT RRUGOR DHE I PASURIVE NR.: 607/34, 607/45, 607/46, 607/50, ZONA KADASTRALE NR. 3252, NDODHUR NË FSHATIN SALARI, NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR

Bazuar në: Nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja "b" dhe pika 1/1.2, nenin 27, pika 5, nenin 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", e ndryshuar; Ligjin nr. 115/2014, datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", e ndryshuar; Ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", e ndryshuar; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", e ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 06.01.2011 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërorë që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 430, datë 11.07.2018 "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-Leje)"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar; Relacionin nr. BT-S-R080622, datë 08.06.2022 të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (DPKZHT) të Bashkisë Tepelenë, Këshilli Bashkiak Tepelenë,

V E N D O S I:

1. Azhurnimin e segmentit rrugor dhe azhurnimin e Pasurive nr.: 607/34, 607/45, 607/46, 607/50, Zona Kadastrale nr. 3252, ndodhur në Fshatin Salari, Njësia Administrative Qendër Tepelenë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar si dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Elvis Shehu

SEKRETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Valbona Çela

Miratuar me: 10 vota
Vota Pro: 10
Vota Kundër: 0
Vota Abstenim: 0
Zbardhur më datë: 01.07.2022